

## NJOFTIM

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.33 Regj. Themeltar, Datë 13.06.2023 Regjistrimi, me:

**PADITËS:** Lefter Maliqi.

**TË PADITUR:** - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.  
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për rrëzimin e pikës 1 të ankimit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ku kam kërkuar, hapjen e kutive për rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr.64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë, (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Më datë **13.06.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Alma Kolgjoka (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Edlira Petri (Anëtare).**

Me Urdhër datë 16.06.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **20.06.2023, ora 09:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore.

Lidhur me ambientin e zhvillimit të seancës gjyqësore, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor caktoi **Gjykatën Administrative të Apelit, në adresën Rr.“Ismail Qemali”, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë**, në kushtet kur prej njoftimit të datës 14.06.2023, në grupin e gazetarëve në aplikacionin WhatsApp, nuk pati asnjë konfirmim për pjesëmarrje në seancë, çka do të diktonte zhvillimin e seancës në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Tiranë, më 19.06.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**